

FUSHA QË MBULON DHE PËRGJEGJËSITË E SECILIT KOMISION

1. Komisioni i Mandateve (3 Anëtarë)

- **Fusha që mbulon:** Legjitimitetin ligjor të përfaqësimit politik.
- **Përgjegjësitë specifike:** Verifikon dokumentacionin e këshilltarëve të rinj që marrin mandatin, trajton rastet e përputhshmërisë së postit, dorëheqjet dhe zëvendësimet sipas listave zyrtare të KQZ-së.

2. Komisioni i Rregulloreve, Çështjeve Juridike (5 Anëtarë)

- **Fusha që mbulon:** Ligjshmërinë dhe përputhshmërinë normative.
- **Përgjegjësitë specifike:** Shqyrton paraprakisht të gjitha projektvendimet për t'u siguruar që nuk bien ndesh me Kushtetutën ose ligjet kombëtare; propozon ndryshime në rregulloret e brendshme të Këshillit Bashkiak.

3. Komisioni i Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave (11 Anëtarë)

- **Fusha që mbulon:** Financat publike vendore dhe politikat fiskale.
- **Përgjegjësitë specifike:** Analizon draft-buxhetin vjetor të bashkisë, ndryshimet e zërave të shpenzimeve gjatë vitit (rialokimet), si dhe miraton ose ndryshon taksat e përkohshme dhe tarifat e shërbimeve që paguajnë qytetarët e bizneset. Shqyrton çdo akt që del nga Drejtoria e Buxhetit.

4. Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike (9 Anëtarë)

- **Fusha që mbulon:** Infrastrukturën jetike dhe programet e strehimit.
- **Përgjegjësitë specifike:** Shqyrton listat e përfituesve të bonuseve të qirasë apo shtëpive sociale. Shqyrton çdo projektvendimin që ka lidhje me infrastrukturën jetike dhe programet e strehimit. Monitoron funksionimin e ndërmarrjeve të pastrimit, ndriçimit publik dhe shërbimeve të varrezave.

5. Komisioni i Mbrojtjes Civile, Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Shëndetësisë (5 Anëtarë).

- **Fusha që mbulon:** Sigurinë e komunitetit, emergjencat dhe shëndetin lokal.
- **Përgjegjësitë specifike:** Shqyrton projektvendime që kanë lidhje me sigurinë e komunitetit, emergjencat dhe shëndetin lokal. Kontrollon planet e emergjencave ndaj tërmeteve, zjarreve apo përmytjeve. Miraton alokimet e fondeve të dëmshpërblimeve të fatkeqësive dhe ndjek cilësinë e shërbimit në qendrat që varen nga bashkia.

6. Komisioni i Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit (5 anëtarë)

- **Fusha që mbulon:** Jetën sociale, edukimin dhe vlerësimet publike.
- **Përgjegjësitë specifike:** Ndjek gjendjen dhe mirëmbajtjen e shkollave, kopshteve dhe çerdheve. Kalon fondet për ngjarjet kulturore, klubet sportive të qytetit dhe shqyrton propozimet për titujt "Qytetar Nderi". Shqyrton çdo projektvendim që del nga Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare të Bashkisë Durrës.

7. Komisioni i Marrëdhënieve me Jashtë dhe Integritimit Evropian (7 anëtarë)

- **Fusha që mbulon:** Bashkëpunimin ndërkombëtar dhe projektet e huaja.
- **Përgjegjësitë specifike:** Shqyrton marrëveshjet e binjakëzimit të Bashkisë Durrës me bashki homologe apo qytete të tjera të botës. Monitoron aplikimet e bashkisë në projektet e Bashkimit Evropian dhe thithjen e granteve ndërkombëtare. Shqyrton çdo projektvendim që ka lidhje me bashkëpunimin ndërkombëtar dhe projektet e huaja.

8. Komisioni i Mjedisit dhe Trajtimit të Mbetjeve (7 anëtarë)

- **Fusha që mbulon:** Mbrojtjen e mjedisit dhe pastrimin e hapësirave publike në territorin e bashkisë Durrës.
- **Përgjegjësitë specifike:** Analizon kontratat e pastrimit të Bashkisë Durrës dhe marrëdhënien kontraktuale me landfill. Monitoron ndotjen e vijës bregdetare, menaxhimin e mbetjeve të ngurta dhe planet për menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane, shtimin e parqeve ose zonave të gjelbra në Durrës. Shqyrton çdo projektvendim që ka lidhje me mbrojtjen e mjedisit dhe pastrimin e territorit të bashkisë.

9. Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Mirëqenies Sociale dhe Mosdiskriminimit (5 anëtarë)

- **Fusha që mbulon:** Ndihmën sociale dhe mbrojtjen e të drejtave.
Përgjegjësitë specifike: Shqyrton ndarjen e ndihmës ekonomike për familjet e varfra, fondet për personat me aftësi të kufizuara, funksionimin e qendrave sociale ose të moshave të treta dhe zbatimin e politikave të barazisë gjinore në administratë.

10. Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës (9 anëtarë)

- **Fusha që mbulon:** Planifikimin hapësinor dhe ndërtimet.
- **Përgjegjësitë specifike:** Filtri kryesor për Planin e Përgjithshëm Vendor (PPV) dhe ato sektoriale. Shqyrton ndryshimet e destinacionit të tokës (p.sh. nga bujqësore në truall ndërtimi) dhe planet për zona të veçanta zhvillimi.

11. Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor (7 anëtarë)

- **Fusha që mbulon:** Administrimin e pasurive të bashkisë dhe transportin urban.
- **Përgjegjësitë specifike:** Vendors për dhënien me qira, shitjen ose marrjen në pronësi të pasurive të paluajtshme. Miraton linjat e autobusëve urbanë, tarifat e biletave, stacionet, parkingjet dhe rregullat për qarkullimin e mjeteve.

12. Komisioni i Politikave të Zhvillimit Ekonomik (7 anëtarë)

- **Fusha që mbulon:** Biznesin lokal dhe investimet tregtare.
- **Përgjegjësitë specifike:** Harton dhe vlerëson strategjitë për nxitjen e tregtisë, krijimin e zonave të lira ekonomike, programet e punësimit dhe lehtësirat për bizneset e vogla e të mesme në rajon.

13. Komisioni i Politikave të Zhvillimit të Turizmit (7 anëtarë)

- **Fusha që mbulon:** Zhvillimin e turizmit, mikpritjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore.
- **Përgjegjësitë specifike:** Shqyrton dhe propozon politika që lidhen me zhvillimin turistik të Bashkisë Durrës, menaxhimin e hapësirave të plazhit, organizimin e sezonit veror, promovimin e turizmit kulturor dhe arkeologjik, si edhe strategjitë për marketingun dhe imazhin e qytetit si destinacion turistik.

14. Komisioni i Etikës, Apelimeve, Konfliktit të Interesit, Peticioneve (7 anëtarë)

- **Fusha që mbulon:** Integritetin institucional dhe zërin qytetar.
- **Përgjegjësitë specifike:** Shqyrton zyrtarisht iniciativat qytetare dhe peticionet që qytetarët i drejtojnë Këshillit Bashkiak. Monitoron zbatimin e Kodit të Etikës nga këshilltarët dhe parandalon rastet kur një anëtar i këshillit bashkiak mund të ketë interes personal në votim.

15. Komisioni i Teknologjisë dhe Inovacionit (5 anëtarë)

- **Fusha që mbulon:** Dixhitalizimin dhe modernizimin e shërbimeve.
- **Përgjegjësitë specifike:** Mbikëqyr kalimin e shërbimeve të bashkisë online (sistemet inteligjente), sigurinë e të dhënave të qytetarëve, si dhe projektet e granteve që mbështesin idetë inovative (start-up) e të rinjve në teknologji.

ROLI KRYESOR I KËTYRE KOMISIONEVE PËRMBLIDHET NË KËTO PIKA TË RËNDËSISHME:

Komisionet e përhershme janë strukturat kryesore të punës së Këshillit Bashkiak dhe luajnë një rol të rëndësishëm në ushtrimin e tre funksioneve themelore të këshilltarëve bashkiakë: rolin vendimmarrës, monitorues dhe përfaqësues të qytetarëve. Përmes punës së tyre, ato sigurojnë që vendimet e bashkisë të jenë të ligjshme, të argumentuara, financiarisht të realizueshme dhe në interes të komunitetit.

1. Shqyrtimi paraprak i projektvendimeve (roli vendimmarrës)

Asnjë projektvendim nuk kalon për votim në mbledhjen e Këshillit Bashkiak pa u shqyrtuar më parë nga komisioni përkatës. Komisionet analizojnë në detaje propozimet e ardhura nga Kryetari i Bashkisë dhe administrata, duke vlerësuar ndikimin, nevojën dhe përputhshmërinë e tyre me interesin publik. Në këtë mënyrë, këshilltarët ushtrojnë funksionin e tyre vendimmarrës mbi baza më të informuara dhe profesionale.

2. Hartimi i raporteve dhe rekomandimeve (roli vendimmarrës dhe përfaqësues)

Pas shqyrtimit të një çështjeje (projektakti), komisioni harton një raport zyrtar ku shprehet nëse është “Pro”, “Kundër” ose propozon ndryshime (amendamente) për projektaktet.

Këto raporte prezantohen në mbledhjen e Këshillit Bashkiak për të orientuar diskutimin dhe votimin e këshilltarëve. Përmes rekomandimeve të tyre, komisionet sigurojnë që vendimmarrja të reflektojë sa më mirë interesat dhe shqetësimet e qytetarëve.

3. Kontrolli i ligjshmërisë dhe financave (roli monitorues)

Komisionet kanë rol të rëndësishëm mbikëqyrës ndaj administratës bashkiake. Komisioni i Rregulloreve, Çështjeve Juridike kontrollon nëse projektvendimet janë në përputhje me legjislacionin në fuqi, ndërsa Komisioni i Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave analizon kostot, burimet financiare dhe justifikimin e shpenzimeve publike.

Ky proces ndihmon në garantimin e transparencës, përgjegjshmërisë dhe përdorimit të drejtë të fondeve publike.

4. Monitorimi dhe mbikëqyrja e administratës (roli monitorues)

Komisionet kanë të drejtë të thërrasin në dëgjesa ose seanca plenare në mbledhje të këshillit bashkiak, drejtues të drejtorive dhe ndërmarrjeve në varësi të bashkisë, si Ndërmarrja e Rrugëve, NSHK Durrës apo NK Plazh, etj.,

Ato ndjekin nga afër mënyrën se si zbatohen planet sektoriale, investimet, projektet dhe shërbimet publike në terren, duke evidentuar problematikat dhe duke kërkuar llogaridhënie nga administrata për sektorët që mbulojnë.

5. Ndërlidhja me qytetarët dhe grupet e interesit (roli përfaqësues)

Komisionet shërbejnë si ura lidhëse mes qytetarëve dhe Këshillit Bashkiak. Përmes dëgjesave publike, konsultimeve dhe takimeve me grupet e interesit, ato mbledhin shqetësimet, propozimet dhe kërkesat e komunitetit për tema të ndryshme, si paketat fiskale, projektet urbane apo shërbimet publike, etj.,

Gjithashtu, komisionet shqyrtojnë peticionet dhe iniciativat qytetare përpara se ato të kalojnë për vendimarrje në Këshill, duke forcuar përfaqësimin demokratik dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në qeverisjen vendore.